



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 9103/prot.

Tiranë, më 28.10.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.766/1, datë 29.10.2014.

**SHOQËRISË “ALION” SH.P.K
Lagjia Uznovë, Rruga Antipatrea, Qarku Berat.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Alion” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.766/1, datë 29.10.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Qarku Berat.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.6366, datë 21.10.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9103, datë 22.10.2019 dhe me shkresën nr. 6161, datë 21.10.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.9099, datë 22.10.2019, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.766/1, datë 29.10.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Qarku Berat, për arsye se:

- Nuk është zhvilluar aktivitet minerar në zonën për të cilën është dhënë leja minerare në përputhje me projektin teknik të miratuar për këtë objekt.

Nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është revokuar leja mjedisore për këtë objekt, me Urdhrin nr.156, datë 07.05.2018.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim, është i mbështetur në germen “dh”, të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Revokimi i lejes mjedisore nga organi kompetent, që ka lëshuar këtë leje mjedisore, sipas germës “h”, të pikës 1, të nenit 47, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, është shkak ligjor për revokimin e një leje minerare.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.766/1, datë 29.10.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Qarku Berat, që shoqëria juaj zotëron. Ju bëjmë**

me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.766/1, datë 29.10.2014, për mineral gëlqeror pllakor, në objektin “Novaj”, Qarku Berat.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËSMINISTRI

ILIR BEJTJA

